



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1345 Prot.

Tiranë, më 09. 09. 2019

### V E N D I M

**Nr. 117, Datë 09. 09. 2019**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 34, datë 04.04.2019, e shtetases E. P., kundër Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të bindjeve politike*<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Ankuesja shpjegon se ka filluar punë pranë Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, më datë 11.04.2016, si Specialiste Marketingu. Më datë 25.05.2017, është transferuar në pozicionin e Specialistes së Burimeve Njerëzore, ku ka punuar për rreth 2 vite. Sipas ankueses, me emërimin në detyrë të Drejtores së Përgjithshme Zh. D., në Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., filluan largimet nga puna të punonjësve të cilët ishin anëtarë të subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”. Me urdhërin Nr. 292 prot., datë 18.04.2018, ankuesja ka kaluar nga pozicioni i Specialistes së Burimeve Njerëzore, në pozicionin e Specialistes së Gjelbërimit.

Me shkresën Nr. 581 prot., datë 30.05.2018, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., ka njoftuar ankuesen se, në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës Nr. 74, datë 27.04.2018, do të zhvillohet takimi ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit për të diskutuar rreth vijimit të

<sup>1</sup> Mbështetur në Kartën e Anëtarësisë Nr. 11998 dhe dokumentacionit bashkëngjitur ankesës, ankuesja është anëtare e subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim.

marrëdhënies të punës. Më datë 04.06.2018, ankuesja është vënë në dijeni se Specialisti i Degës Teknike ka dhënë dorëheqjen dhe në këto kushte ajo i është drejtuar punëdhënësit me shkresën Nr. 590 prot., datë 04.06.2018, ku ka kërkuar të emërohet në atë pozicion pune duke qënë se ishte vakant. Në përgjigje të kërkesës së saj, punëdhënësi ka informuar ankuesen se nuk mund të emërohet në pozicionin e kërkuar, pasi për të kishte nisur tashmë procedura për zgjidhjen e marrëdhënies të punës. Sipas ankueses pavarësisht se kishte nisur procedura për largimin nga puna, ka patur edhe raste të tjera ku punonjësit janë emëruar në pozicione pune, apo janë lëvizur në një pozicion tjetër edhe gjatë procedurave të zgjidhjes së marrëdhënies të punës, nga ana e punëdhënësit. Në këto kushte, ankuesja pretendon se përmes veprimeve apo mosveprimeve të kryera, punëdhënësi ka patur synim përfundimtar largimin e saj nga puna.

Përsa më lart, ankuesja pretendon se largimi nga puna është bërë për shkak të bindjeve politike dhe jo për shkak të ristrukturimit të shoqërisë. Sipas saj, në raport me punonjës të tjerë, ankueses nuk i është ofruar asnjë pozicion tjetër pune, por është marrë masa e largimit nga puna. Gjithashtu përpara largimit të saj nga detyra, në Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., janë emëruar rreth 13 punonjës të rinj.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, E. P. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë situatën diskriminuese.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së<sup>2</sup>, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

---

<sup>2</sup> Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Përsa më lart, me anë të shkresës Nr. 536/1 prot., datë 11.04.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar subjektit Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., ku i ka kërkuar informacion dhe parashtrime rreth ankesës së paraqitur nga ana e E. P.
- Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me shkresën<sup>3</sup> Nr. 154/1 prot., datë 23.04.2019, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a., ndër të tjera sqaroi se: *“...Në lidhje me pretendimin se me emërimin e Zh. D. si titullare e Shoqëria Trajtimi i Studentëve Nr. 2 sh.a., filluan largimet nga puna të punonjësve të cilët ishin anëtarë të subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, ky pretendim është i pabazuar në prova dhe në fakte, pasi largimet që janë bërë pas emërimit të Zh. D., kanë qënë dorëheqje të punonjësve, zgjidhje kontratës nga ana e punëmarrësve “braktisje të vendit të punës” dhe largime për shkak të suprimimeve të vendit të punës të cilat erdhën si rezultat i miratimit të Strukturës së re të Shoqërisë me vendim nr. 76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikqyrës. Është evident fakti se E. P. ka pasur vlerësimin nga Zh. D., pasi menjëherë pas emërimit të saj, Kryetarja e Degës së Burimeve Njerëzore ka kryer lejen prej 1 muaj, të pakryer nga viti 2017 dhe e gjithë puna është kryer nga Specialistja e Burimeve Njerëzore, E. P. Gjithashtu puna e saj ka vazhduar normalisht si Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe pas emërimit të Kryetares së re të Burimeve Njerëzore, pasi znj. P. S. kaloi në detyrë Kujdestare Godine Nr. 1, Sektori Inxhinieri. **Pra, pretendimi se me ardhjen e Zh. D. ndaj E. P. janë kryer veprime diskriminuese nuk qëndron dhe është i pa mbështetur në ligj dhe në prova, pasi deri në momentin e suprimimit të pozicionit të punës ajo ka vazhduar normalisht marrëdhënien e punësimit. Implementimi i strukturës është bërë duke rikonfirmuar të gjithë pozicionet ekzistuese me strukturën e re dhe pas përfundimit të impelmentimit, filluan procedurat ligjore të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për ato pozicione pune që u suprimuan dhe u ndryshua struktura e të gjithë Sektorit të Gjelbërimit, duke e lënë me 2 Specialist Gjelbërimi dhe 4 Punonjës Gjelbërimi. Me miratimin e Strukturës filloi dhe implementimi i saj, dhe për çdo pozicion të suprimuar filluan procedurat ligjore të suprimimit të vendit të punës duke ndjekur të gjithë rrugën ligjore në zbatim të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë. Siç vërtetohet dhe shihet, për E. P. është ndjekur procedura ligjore, duke e njoftuar për takimin lidhur me***

<sup>3</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 536/2 prot., datë 23.04.2019

*ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe duke shtyrë procedurën e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, për shkak të Raportit Mjekesor të paraqitur nga E. P., lejes vjetore dhe lejes pa të drejtë page, duke qënë se do të largohej jashtë vendit për kurimin e vajzës së saj. E. P. është trajtuar si të gjithë punonjësit e tjerë dhe në asnjë moment të vetëm nuk janë ndërmarrë veprime diskriminuese...Veprimet e RSU2 kanë pasur për qëllim bërjen e një procedure sa më të rregullt në përzgjedhjen e personave kur suprimohet një vend pune, duke marrë në konsideratë eksperiencat profesionale të punonjësve, performancat e tyre, kohëzgjatjet e marrëdhënieve të punës në atë pozicion etj. Të gjitha këto veprime tregojnë se nga ana e RSU2 nuk janë ndërmarrë në asnjë moment veprime diskriminuese si ndaj E. P. por edhe ndaj punonjësve të tjerë. Gjatë takimit E. P. është vënë në dijeni se i vetmi shkak i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës është ai i suprimimit dhe nuk ka asnjë vend të lirë që të përshtatej me arsimin e lartë që ajo ka përfunduar. **Së dyti**, në lidhje me pretendimin e saj për të kaluar në detyrën e specialistes së Planifikimit në Drejtorinë Teknike, i është kthyer përgjigje duke i sqaruar se për të ka nisur procedura e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe nuk mund të kalojë në pozicionin e kërkuar. **Përsa më sipër pretendimi i saj se është larguar nga puna për shkak të bindjeve politike dhe jo për shkak të ristrukturimit është i pabazuar në prova, pasi faktet provojnë vërtetësisht se E. P. i është suprimuar vendi i punës dhe se në momentin kur i ka rifilluar procedura e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, nuk ka pasur asnjë pozicion pune që të mund ti përshtatet përgatitjes profesionale të saj. Së treti**, emërimi i punonjësve të rinj nuk ka të bëjë me faktin se E. P. është diskriminuar politikisht. Punonjësit e rinj janë emëruar në pozicione të ndryshme duke u përshtatur arsimin përkatës të tyre me pozicionin e punës. **Së katërti**, Në lidhje me pretendimin se persona të tjerë janë emëruar si punonjës të rinj të cilët nuk plotësojnë kriteret, ky pretendim nuk është i bazuar në prova, pasi bashkëngjitur kësaj shkrese do të gjeni dosjet e personave të cilët janë emëruar Inxhinier dhe kanë arsimin përkatës që i përshtatet pozicionit të punës, por edhe kualifikimet e duhura ndoshta dhe më të kualifikuar...”.*

Në mbështetje të pretendimeve të tyre Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, vunë në dispozicion të Komisionerit:

- Kopje të kontratës së punës dhe të dosjes personale të E. P.
- Kopje e vlerësimit të punës të subjektit ankues.
- Informacion lidhur me performancën e saj në punë.
- Informacion lidhur me punonjës të tjerë të shoqërisë të cilëve u është suprimuar pozicioni i punës dhe janë emëruar në një pozicion tjetër pune.
- Kriteret që kërkohen për pozicionet e punës Specialist i Burimeve Njerëzore, Specialist Gjelbërimi dhe Specialist i Degës Teknike.

- Kopje të dosjeve të punonjësve të cilët janë emëruar me detyrë Specialist i Burimeve Njerëzore, Specialist Gjellbërimit dhe Specialist i Degës Teknike në Shoqërinë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”.
  - Informacion nëse ankuesja e ka kundërshtuar gjyqësisht ndryshimin e pozicionit të punës. Nëse po, një kopje të aktit. (kërkesë padisë)
  - Kopje të Raportit Përfundimtar të KLSH-së Nr. 77/10, datë 22.11.2017, me Nr. 451 prot., datë 23.11.2017, në zbatim të rekomandimit “Për përshtatjen e vendeve të punës sipas profesioneve”.
- Me anë të e-malit datë 19.06.2019, nga ana e përfaqësueses me prokurë<sup>4</sup> të posaçme të ankueses, u vu në dispozicion të Komisioneri informacioni se: *“Ndryshimet e strukturës Nr. 63, datë 17.11.2017 në atë me Nr. 76, datë 27.04.2018, kanë sjellë suprimimin e pozicionit të punës së Përgjegjës të Gjellbërimit dhe jo të Specialistit të Gjellbërimit që ka mbajtur ankuesja”*.
  - Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 34, datë 04.04.2019, Komisioneri me shkresën nr. 536/3 prot., datë 10.06.2019, pasi mori miratimin e palëve në proces, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 20.06.2019.

Në seancë ishte e pranishme vetëm Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, përfaqësuar nga E. K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore, ndërsa pala ankuese më datë 19.06.2019, njoftoi për pamundësinë për të qënë prezent në seancë.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, pala ndaj së cilës është paraqitur ankesa i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në vijim të seancës, përfaqësuesja e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” Tiranë, informoi KMD-në ndër të tjera se: *“Pas raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Shoqëria nisi të përshtasë punonjësit sipas pozicioneve të punës, mbështetur në arsimin e tyre, eksperiencën në punë etj. Referuar pozicionit të punës Specialist i Burimeve Njerëzore që ka mbajtur ankuesja, u bë largimi i ankueses nga ky pozicion dhe emërimi në pozicionin e Specialistes së Gjellbërimit. Kjo për shkak se arsimi që kishte përfunduar ankuesja (Inxhinieri Agromjedisi) përkonte me kërkesat e pozicionit të punës së Specialistit të Gjellbërimit dhe jo atij të Specialistit të Burimeve Njerëzore (i cili kërkonte arsimin e lartë në Drejtësi). Në vijim me miratimin e strukturës Nr. 76,*

<sup>4</sup> Nr. 1228 rep., Nr. 477 kol, datë 28.05.2019, ankuesja emëron në cilësinë e përfaqësueses ligjore Avokaten A. R.

*datë 27.04.2018, u shkurtua pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Gjelbërimit. Në këto kushte, referuar eksperiencës në punë, arsimin përkatës etj., punonjësja që mbante pozicionin e Përgjegjës së Sektorit të Gjelbërimit u emërua në njërin prej pozicioneve Specialiste Gjelbërimit. Duke qënë se një prej punonjësve Specialist Gjelbërimit ishte person me aftësi të kufizuara (vërtetuar me dëshminë përkatëse) dhe mbushte moshën e pensionit në muajin Janar 2019, nuk u pa i arsyeshëm largimi i tij, pasi nëse do të zgjidhej kontrata e tij do të ishim përpara faktit të diskriminimit. Gjithashtu, shoqëria kishte të emëruar edhe një punonjës tjetër specialist gjelbërimit, por duke qënë se ishte komisionuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë dhe ishte në kushtet e paaftësisë së plotë për punë, shoqëria priste largimin e tij nga ky pozicion, pasi prej 6 muajsh ky punonjës paguhej nga ana e Sigurimeve Shoqërore dhe jo nga ne. Në kushtet që shoqëria kishte të nevojshëm ushtrimin e funksionit të Specialistit të Gjelbërimit, u mendua emërimi i ish Përgjegjës së Sektorit të Gjelbërimit në këtë pozicion.”*

Përsa i pëket refuzimit të Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” Tiranë, të emërojë ankuesen në pozicionin e Specialistes së Planifikimit në Drejtorinë Teknike, përfaqësuesja e shoqërisë u shpreh ndër të tjera se: “...E. P. është bërë me dije nga ana e shoqërisë se për të kishte nisur procedura e zgjidhjes së kontratës së punës dhe nuk mund të bëhej emërimi në atë pozicion pune. Gjithashtu fakti që ajo ishte me raport mjekësor, nuk mund të emërohej në pozicionin e kërkuar pasi do të ndodheshim përpara zgjidhjes së kontratës së punës gjatë kohës që ankuesja ishte me raport mjekësor dhe lidhjes së një kontrate të re pune. Pra ishte pezulluar procedura e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës për ankueses për shkak të raportit mjekësor dhe nuk mund të bënim zgjidhjen apo lidhjen e një kontrate të re pune. Një tjetër arsye e refuzimit të emërimit të ankueses në pozicionin e Specialistes së Planifikimit ishte dhe fakti që ajo nuk plotësonte kriterin arsimor për këtë pozicion pune.”

Lidhur me pretendimin e ankueses se për punonjës të tjerë të shoqërisë pavarësisht se u kishte filluar procedura e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, atyre u është gjetur një pozicion tjetër dhe nuk janë larguar nga puna, përfaqësuesja e shoqërisë sqaroi ndër të tjera se: “...ka patur raste kur një punonjësi për shkak të suprimimit të pozicionit të punës i kishte nisur procedura e zgjidhjes së kontratës së punës, por i është ndërprerë pasi shoqëria është vënë në dijeni se punonjësi ka qënë kujdestari ligjor i bashkëshortes së tij dhe ka qënë i vetmi person që mund të siguronte të ardhura në familje. Në këto kushte, është parë e arsyeshme ndërprerja e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës dhe emërimi në një pozicion pune ku plotësonte kërkesat.”

Në përfundim, nga ana e përfaqësueses së Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, u theksua edhe një herë se duke qënë se pozicioni i punës u shkurtua dhe arsimit<sup>5</sup> i E. P. nuk përshtatej me asnjë nga pozicionet e strukturës së re, atëherë u bë zgjidhja e kontratës së punës me të. Në këtë kuptim, sipas saj largimi nga puna nuk lidhet me bindjet politike të ankueses, por vetëm me

---

<sup>5</sup> Inxhinieri Mjedisi

shkurtimin e pozicionit të punës dhe mos përshtatjen e arsimit të saj me pozicionet e tjera në strukturë.

Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore, nga ana e përfaqësueses së Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, shkresa<sup>6</sup> Nr. 82/2 prot., datë 08.05.2019, ku ndër të tjera sqarohej se: “...bashkëngjitur kësaj shkrese po ju paraqesim faktin se pranë Shoqërisë, vazhdojnë të punojnë punonjës të cilët janë të anëtarësuar në forcën politike LSI, si: I. F., me detyrë Përgjegjës Sektori Mjekësi, Drejtoria Teknike; D. M., me detyrë Zv/Përgjegjëse Godina Nr. 2, Drejtoria e Mirëadministrimit; Y. Z., me detyrë Përgjegjës Emergjence, Sektori Inxhinieri, Drejtoria Teknike; Q. B. Me detyrë marangoz, Drejtoria Teknike; N. M., me detyrë Hidraulik, Drejtoria Teknike; G. T., me detyrë Punonjës Gjelbërimi, Drejtoria Tenike; Xh. B., me detyrë Sanitare, Drejtoria e Hotelarisë dhe B. D., me detyrë Receptonist Administrate, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Burimeve Njerëzore.”. Bashkëngjitur kësaj shkrese, Shoqëria Trajtimi i Studentëve Nr. 2, Tiranë, vuri në dispozicion të KMD-së, kartat e anëtarësisë në subjektin politik Lëvizja Socialiste për Integrim, të punonjësve të cituar në shkresën e mësipërme.

- Në vijim të procedurës hetimore për marrjen e çdo prove dhe informacioni që i shërben procesit, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, me shkresën<sup>7</sup> Nr. 154/5 prot., datë 02.07.2019, vuri në dispozicion të KMD-së, informacion shtesë lidhur me pretendimet e ngritura nga ankuesja.

Në referim të shkresës së sipërcituar Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, sqaroi ndër të tjera se: “... në zbatim të pikës 3 të nenit 143 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, afati i njoftimit për zgjidhje të kontratës pezullohet gjatë periudhës së paaftësisë për punë, shtatëzani ose pushimeve të dhëna nga punëdhënësi. Në kuptim të këtij neni, lëvizja në detyrë ka të bëjë me ndryshime të kushteve të kontratës të cilat konsistojnë si në përshkrimin e punës ashtu dhe në atë të pagesës, prandaj nuk mund të bëhen lëvizje në detyrë gjatë periudhës së paaftësisë. Ndërsa në lidhje me fillimin e procedurës, për aq kohë sa procedura e zgjidhjes së kontratës është pezulluar deri në riaftësimin e punonjësit, duhej që punonjësi të rikthehej në punë, që të mund të vazhdohej me procedurën qoftë deri në përfundim të saj ose të pushimit të saj.”

Lidhur me procedurën e largimit të Specialistit të Gjelbërimit, shtetasit L. L., Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, sqaroi ndër të tjera se: “...L. L. ish punonjës i RSU 2, në Specialist Gjelbërimi që nga muaji shkurt ka filluar me 10 ditë raport të paguara nga punëdhënësi pasi bëri një ndërhyrje kirurgjikale në zemër. Pas muajit shkurt siç duket nga dokumenti bashkëngjitur, ka qënë me raport të paguar nga sigurimet shoqërore, raport ky i cili ka vazhduar deri në muajin gusht, ku ish punonjësi ka kryer leje vjetore për vitin 2018 dhe më pas ka qënë në

<sup>6</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 818 prot., datë 29.05.2019.

<sup>7</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 536/4 prot., datë 04.07.2019.

*procedurë KEMP vendim i cili e diagnostikoi Invalid të plotë, i paaftë për punë. Marrëdhënia e punës u ndërpre më datë 14.12.2018”.*

Sa i përket punonjësve të tjerë të cilëve u ka filluar procedura e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe u është ndërprerë, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, sqaroi se: “...po gjatë vitit 2018 pas implementimit të Strukturës nr. 76 prot., datë 27.04.2018, ka pasur një rast të fillimit të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, rasti i G. T. dhe u ndërpre pasi gjatë takimit midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, para komisionit nga ana e punëmarrësit u paraqit një vendim gjykate i cili kishte vendosur se G. T. është kujdestari ligjor i bashkëshortes së tij, pasi asaj i ishte hequr zotësia juridike për të vepruar. Në këto kushte, komisioni mori vendimin që ta anulojë procedurën e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe i propozoi titullarit që në këto kushte G. T. të mos i ndërpriten marrëdhëniet e punës për vetë kushtet që ai ndodhet.”

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Nga kqyrja e dokumentacionit të depozituar pranë KMD-së, rezulton se, E. P. ka filluar punë pranë Shoqërisë Trajtimi i Studentëve Nr. 2, Tiranë, me datë 11.04.2016<sup>8</sup> në pozicionin “Specialiste Marketingu”. Pasi ka punur në këtë pozicion pune për rreth 1 muaj e gjysëm, me Urdhërin Nr. 253 prot., datë 25.05.2016, ankuesja ka kaluar nga pozicioni i Specialistes së Marketingut në pozicionin Specialiste e Burimeve Njerëzore. Këtë pozicion pune ankuesja e ka mbajtur deri në datën 18.04.2018, kur Administratori i Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, me Urdhërin Nr. 292, datë 18.04.2018, ka kaluar E. P. në pozicionin e Specialistes së Gjelbërimit. Referuar dokumentacionit, me shkresën Nr. 581 prot., datë 30.05.2018, ankuesja është njoftuar nga punëdhënësi për zhvillimin e një takimi për të diskutuar lidhur me mundësinë e zgjidhjes së kontratës së punës. Më datë 04.06.2018, punëdhënësi i saj ka mbajtur procesverbalin<sup>9</sup> e takimit lidhur me vijimin e marrëdhënieve të punës, në të cilin evidentohet se ankuesja nuk ka qënë prezent për shkaqe shëndetësore dhe nga ana e punëdhënësit citohet se referuar parashikimeve<sup>10</sup> të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, takimi do të shtyhej deri në riaftësimin e saj. Me shkresën Nr. 581/2 prot., datë 06.09.2018, ankuesja është njoftuar sërish nga punëdhënësi për zhvillimin e një takimi për të diskutuar lidhur me mundësinë e zgjidhjes së kontratës së punës. Më datë 12.09.2018, ndërmjet ankueses dhe punëdhënësit është mbajtur procesverbali<sup>11</sup> i takimit, në të cilin ankuesja është njoftuar lidhur me shkaqet e largimit nga detyra. Pas takimit të zhvilluar, punëdhënësi ka njoftuar ankuesen lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me Vendimin Nr. 581/4 prot., datë 17.09.2018, në të cilin sqarohet se

<sup>8</sup> Referuar shkresës Nr. 163 prot., datë 11.04.2016 “Emërim në detyrë”, të Shoqërisë Trajtimi i Studentëve Nr. 2 Tiranë.

<sup>9</sup> Nr. 581/1 prot., datë 04.06.2018

<sup>10</sup> Neni 147, pika 2

<sup>11</sup> Nr. 581/3 prot., datë 12.09.2018



arsyeja e ndërprerjes së kontratës së punës është suprimimi i pozicionit që ajo mbante. Në dosjen e ankueses është depozituar dokumentacioni provues lidhur me kualifikimin e saj: - Diplomë të Nivelit të Parë nr. 196, e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, në Inxhinieri Agromjedi; Diplomë të Nivelit të Dytë Nr. 469, datë 26.12.2010, në Inxhinieri Mjedi, Profili Inxhinieri Agromjedi.

**A/1. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë, sa i përket largimit nga pozicionet Specialist i Burimeve Njerëzore dhe Specialist Gjellërimi.**

Bazuar në aktet e administruara nga Komisioneri rezulton se, me Vendimin nr. 63, datë 17.11.2017 të Këshillit Mbikqyrës është miratuar struktura e Shoqërisë për vitin 2018, e cila në total parshikonte 192 punonjës. Nga këta 1 Përgjegjës Gjellërimi dhe 2 Specialist Gjellërimi ishin parashikuar për Sektorin e Gjellërimin. Theksojmë se, referuar parashikimit të kriterit arsimor të kësaj strukture, për pozicionet Përgjegjës dhe Specialist Gjellërimi, ishte parashikuar që kriteri i kërkuar të ishte “Arsimi i lartë”.

Ndërkaq, nëpërmjet shkresës me nr. 770/10 prot., datë 22.11.2017 të KLSH-së<sup>12</sup> “Raport Përfundimtar dhe Rekomandime për Auditimin e Shoqërisë”, Drejtorisë së Shoqërisë dhe Këshillit Mbikqyrës iu rekomandua të marrin masa për rishikimin e strukturës organizative, për përshtatjen e vendit të punës sipas profesioneve, duke shmangur dublimet në detyrat e punonjësve dhe punësimet e panevojshme.

Në zbatim të rekomandimeve sipërcituar, të lëna nga KLSH-ja, me Vendim nr. 76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikqyrës u miratua struktura e Shoqërisë për vitin 2018, me gjithsej 186 punonjës. Dega Teknike u emërtua Drejtoria Teknike dhe gjithsej ishte parashikuar të kishte 52 punonjës. Referuar kësaj strukture, Sektori i Gjellërimin kaloi nën varësinë e Drejtorisë Teknike dhe pozicioni “Përgjegjës Gjellërimi” është shkurtuar në strukturën e re të miratuar.

Sipas informacionit dhe provave të administruara, gjatë muajit Janar 2018, Dega e Burimeve Njerëzore (dosjet e personelit), i është nënshtruar një Auditimi të Brendshëm, objekt i të cilit ka qënë kryesisht përputhshmëria e arsimit të punonjësve me pozicionin e punë. Nga “Raporti mbi auditimin e degës së Burimeve Njerëzore”, që mban Nr. 137 prot., datë 05.03.2018, ndër të tjera është konstatuar<sup>13</sup> një numër prej 35 punonjësish të cilëve nuk u përputhej arsimi përkatës, me arsimin sipas strukturës së shoqërisë. Ndër punonjësit që nuk i përshtatej arsimi me pozicionin e punës ishte dhe ankuesja, E. P. Në përfundim të Raportit të Auditit të Brendshëm është rekomanduar ndër të tjera se: “Struktura e shoqërisë ka nevojë për rishikim si për disa pozicione pune që janë në varësi të disa degëve që nuk ka lidhje të drejtëpërdrejta pune, por edhe për të përshtatur çdo pozicion pune me arsimin përkatës...”. Referuar Raportit të sipërcituar të KLSH-së dhe Raportit të Auditit të Brendshëm, Këshilli Mbikqyrës me Vendim nr. 76, datë 27.04.2018,

<sup>12</sup> Shkurtesë për Kontrollin e Lartë të Shtetit.

<sup>13</sup> Në faqen 4-5

miratoi strukturën e re të shoqërisë për vitin 2018 ku specifikoi saktësishtkërkesat që duhet të plotësoi një punonjës, sipas pozicioneve të punës.

Refruar strukturës së vjetër nr. 63, datë 17.11.2017, evidentohet se për pozicionet e punës: Specialist i Burimeve Njerëzore dhe Specialist Gjelbërimi kërkohej vetëm arsimi i lartë pa specifikuar kërkesa të tjera shtesë.

Ndërsa, në analizë të dy strukturave (nr. 63, datë 17.11.2017 dhe nr. 76, datë 27.04.2018), pozicioni i punës së Specialistit të Burimeve Njerëzore, me miratimin e strukturës nr. 76, datë 27.04.2018, kërkonte një punonjës i cili të plotësonte këto kërkesa:

- Arsimi: Bachelor/Master Juridik ose Ekonomik
- Eksperienca në punë: 3 vjet në fushën përkatëse
- Kualifikime: përbëjnë avantazh
- Njohuri të gjuhëve të huaja: përbëjnë avantazh
- Liçenca: përbën avantazh

Pozicioni i punës së Specialistit të Gjelbërimit, në strukturën e re nr. 76, datë 27.04.2018, duhet të plotësonte këto kritere:

- Diploma: Bachelor/Master shkenca Agronomi, Inxhinieri Pyjore ose ekuivalente me to
- Eksperienca në punë: mbi 3 vjet
- Kualifikime: përbëjnë domosdoshmëri.

Në analizë të informacionit të sipërcituar dhe arsimit të përfunduar, ankuesja plotësonte vetëm kriteret e pozicionit të punës së Specialistes së Gjelbërimit. Në referim të provave të administruara, rezulton se në strukturën e vjetër nr. 63, datë 17.11.2017, Sektori i Gjelbërimit përbëhej nga 1 Përgjegjës Gjelbërimi, në të cilin ishte emëruar që prej datës 03.02.2014 M. Z. dhe 2 Specialist Gjelbërimi, shtetasit M. Rr. dhe L. L. Specialisti i Gjelbërimit L. L., që prej muajit Shkurt 2018 deri më datë 14.12.2018, ka qënë me paaftësi të përkohshme në punë, të paguar nga ana e Sigurimeve Shoqërore.

Neni 147, pika 1 e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën në kohën kur, sipas legjislacionit në fuqi, punëmarrësi përfiton pagesë paaftësie të përkohshme në punë nga punëdhënësi ose sigurimet shoqërore, për një periudhë deri në një vit, si dhe kur punëmarrësi është me pushime të dhëna nga punëdhënësi”*.

Përsa më lart, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, ka qënë në kushtet që nuk mund të ndërpriste marrëdhënien e punës me shtetasin L. L., për shkak se ai kishte paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë.

Përsa i përket punonjësit M. Rr., referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, ky shtetas më datë 29.01.2019, mbushte moshën e pensionit, si dhe ishte deklaruar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, invalid i pjesshëm.

Në analizë të pretendimeve dhe provave të administruara, Komisioneri administroi dokumentacionin përkatës të punonjësve të emëruar në pozicionin Specialist Gjelbërimi, dhe evidentoi se:

- M. Z., e cila ka përfunduar arsimin e lartë në degën Agronomi, në Fakultetin e Bujqësisë, ku i është dhënë titulli Agronom i Lartë, emëruar në pozicionin Specialiste Gjelbërimi, Drejtoria Teknike, më datë 30.04.2018, pozicion ku arsimi i përcaktuar është Bachelor/Master shkenca Agronomi, Inxhinieri Pyjore ose ekuivalente me to. **(Plotëson kriteret)**
- M. Rr., pavarësisht faktit që është kërkuar shkresërisht nga Komisioneri, Shoqëria “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokumentacion lidhur me arsimin apo kualifikimet e tij.
- L. L., i cili ka përfunduar arsimin e lartë në degën Kufi, Akademia e Rendit Publik, emëruar në pozicionin Specialist Planifikimi, më datë 16.06.2016, pozicion ku arsimi i përcaktuar është Bachelor/Master shkenca Agronomi, Inxhinieri Pyjore ose ekuivalente me to. **(Nuk plotëson kriteret)**

Në analizë të emërimeve të sipërcituara dhe strukturës së shoqërisë, evidentohet se pozicionet e specialistëve kërkojnë kryesisht arsimin e lartë Bachelor/Master shkenca Agronomi, Inxhinieri Pyjore ose ekuivalente me to. Në këtë kuptim, konstatohet se ankuesja plotësonte kriteret e pozicionit të punës, në kushtet që ka përfunduar arsimin e lartë në Inxhinieri Agromjedisi, ka përvojën dhe kualifikimet e kërkuara.

Me miratimin e strukturës nr. 76, datë 27.04.2018, pozicioni i punës së Përgjegjës të Gjelbërimit që mbante punonjësja M. Z., u shkurtua dhe me Vendim nr. 456, datë 30.04.2018, ajo ka kaluar në pozicionin e Specialistes së Gjelbërimit. Në këtë kuptim, në strukturën e Drejtorisë Teknike duhet të ekzistonte i lirë pozicioni i Specialistit të Gjelbërimit për tu emëruar M. Z. Në kushtet që, 2 pozicionet e Specialistëve të Gjelbërimit nuk ishin të lira, atëherë emërimi i saj ishte i pamundur. Në këtë kuptim, nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlligjin faktin se largimi nga puna i ankuseses, ka ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesja, në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, duke e larguar nga puna.

**A/2. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë, sa i përket kërkesës së ankueses për transferimin në pozicionin Specialist Planifikimi i Drejtorisë Teknike, Sektori Mjekësisë.**

Refruar strukturës nr. 63, datë 17.11.2017, evidentohet se për pozicionet e punës: Specialist Planifikimi, në Degën Teknike kërkohej vetëm arsimi i lartë pa specifikuar kërkesa të tjera shtesë.

Ndërsa, në analizë të dy strukturave (nr. 63, datë 17.11.2017 dhe nr. 76, datë 27.04.2018), pozicioni i punës së Specialistit të Planifikimit, në Drejtorinë Teknike me miratimin e strukturës nr. 76, datë 27.04.2018, kërkonte një punonjës i cili të plotësonte këto kërkesa:

- Arsimi: Bachelor/Master në shkencë Juridike- Ekonomike, Inxhinieri Mekanike
- Eksperienca në punë: mbi 2 vjet
- Kualifikime: përbëjnë avantazh
- Njohuri të gjuhëve të huaja: përbëjnë avantazh

Në analizë të informacionit të sipërcituar dhe arsimit të përfunduar, ankuesja nuk plotësonte kriteret e pozicionit të punës së Specialistit të Planifikimit në Drejtorinë Teknike. Në këto kushte, nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, lidhur me refuzimin e emërimit në pozicionin e Specialistes së Planifikimit në Drejtorinë Teknike.

**B. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>14</sup>, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk

---

<sup>14</sup>“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”

posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se “*bindjet politike*” është shkak për të cilin ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ofron mbrojtje.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër*”.

Po ashtu, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, në nenin 9<sup>15</sup> të tij “Ndalimi i diskriminimit”, parashikon “*bindjet politike*” si shkak për të cilin ky ligj ofron mbrojtje nga diskriminimi.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, Komisioneri gjykon se “*bindjet politike*” konsiderohen si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

Subjekti ankues provon anëtarësinë në forcën politike të subjektit politik, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), me Kartën e Anëtarësisë Nr. 11998 dhe dokumentacionit bashkëngjitur ankesës.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.**

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” Tiranë, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>16</sup> dhe trajtimit të padrejtë apo të pafavorshëm të ankueses.

<sup>15</sup> “*Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët*”.

<sup>16</sup> Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se, E. P. i është nënshtruar një qendrimi të padrejtë nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” Tiranë, krahasuar me punonjësen që është emëruar në pozicionin e Specialistes së Gjelbërimit.

Në kontekst të provimit të faktit që ankuesja nuk është diskriminuar për shkak të bindjeve të saj politike, Shoqëria, ka depozituar pranë KMD, në cilësi prove dokumentacion përkatës, me anë të të cilit provon faktin se:

- Ka dhe punonjës të tjerë<sup>17</sup> të Shoqërisë, që deklarojnë bindjet e tyre politike, si dhe anëtarësinë në subjektin politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, dhe që nuk janë penalizuar për këtë shkak, por vijojnë të jenë në punë dhe aktualisht. Dokumentacion provues lidhur me këtë fakt, në referim të punonjësve I. F., D. M., Y. Zh., Q. B., N. M., G. T., Xh. B. dhe B. D. është depozituar pranë KMD-së.
- Rezultojnë se 5 nga punonjësit e sipërcituar janë pjesë e Drejtorisë Teknike dhe 1 prej tyre Punonjës Gjelbërimi.

Referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të faktit se E. P. i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” Tiranë, nuk provohet që ky trajtim të ketë ardhur për shkak të bindjeve të saj politike.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasës E. P. nga ana e Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2”, Tiranë, për shkak të “bindjes politike”.

---

prindërore, përgjegjësini prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>17</sup> Referuar shkresës Nr. 82/2 prot., datë 08.05.2019, vënë në dispozicion të KMD-së

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONER**

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)